

SI FUNKSIONON?

Shërbimi i pyetjeve

Këndi Juaj i BE ofron një shërbim pyetjesh dhe kërkesash. Orari i punës është nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 deri më 16:00. Ju mund të na drejtoni pyetjet tuaja duke ardhur personalisht, nëpërmjet telefonit ose me shkrim përmes postës elektronike apo letrave. Ne do të përgjigjemi brenda 48 orëve gjatë ditëve të javës. Në ndonjë rast, mund t'Ju drejtojmë pranë autoritetit përkatës në Shqipëri.

Vizitat

Mund ta vizitoni Këndin e BE në qytetin tuaj, ku Koordinatori Lokal i BE do t'Ju sugjerojë burimet më të mira sipas nevojave tuaja, dhe do t'Ju tregojë se si mund të përdorni bazat përkatëse të të dhënave.



Botimet

Këndi i BE në qytetin tuaj disponon një sërë materialesh informuese në lidhje me BE-në. Të gjitha materialet ofrohen falas. Botimet elektronike mund të merren përmes postës elektronike ose të shkarkohen nga faqja jonë e internetit (www.bpe.al).

SEANCAT E INFORMIMIT

DHE PROGRAMET E TRAINIMIT

Këndi i BE në qytetin tuaj organizon leksione mbi BE dhe aktivitetet e saj. Ligjëratat mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga një hyrje e përgjithshme mbi BE deri në prezantimin e një tematike të veçantë.

Ne ofrojmë gjithashtu trajnime mbi mënyrat se si mund të kërkonit informacion në lidhje me BE në internet. Gjatë organizimit të trajnimeve tona, ne bashkëpunojmë me mësuesit, gazetarët dhe njësi të tjera vendore që ofrojnë informacion. Me shumë kënaqësi mund të ofrojmë informacion të mëtejshëm, sipas kërkesave!

FAQE INTERNETI E MEDIA SOCIALE

Këndi i BE në qytetin tuaj është pjesë e projektit "Bashkitë për në Evropë", ndaj çdo gjë që dëshironi të dini është e mundur nëpërmjet faqes së projektit "www.bpe.al" - E lehtë për t'u përdorur me disa seksione ndërvepruese informacioni.

ÇFARË OFROJMË

NË KËNDIN E BE NË BASHKINË TUAJ

EJANI DHE MERRENI VETË INFORMACIONIN

GAME E GJERË LIBRASH DHE BOTIMESH QË FORMOJNË BIBLIOTEKËN TONË TË BE.

Gjithashtu Ju mund të vizitoni faqen e internetit të Shtëpisë së Evropës në Tiranë (www.europehouse.al), ku madje mund të regjistroheni për të marrë gazetën e përmuajshme elektronike. Mund ti jepni koordinatori tuaj vendor të BE adresën tuaj Email, dhe do të merrni nëpërmjet postës suaj elektronike njoftime në lidhje me aktivitetet që ne organizojmë. Gjithashtu, Ju mund të na gjeni në median sociale të bashkisë apo të Delegacionit të BE në Shqipëri.



KENDI I BE NE QYTETIN TUAJ

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian?

Ti dhe BE?

Çfarë di në lidhje me BE ?

Dëshiron të dish më shumë? Na pyesni!

Vizito Këndin e BE-së në qytetin tënd për të mësuar më shumë.

www.bpe.al

KËNDI I BE NË BASHKINË TUAJ

Krijimi i Këndit të BE në qytetin tuaj, është mbështetur nga “Bashkitë për në Evropë”,

një projekt i financuar nga Delegaoni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Qëllimi i Këndit të BE në qytetin tuaj është të sigurojë informacion në lidhje me BE, institucionet dhe politikat e saj, marrëdhëniet e Shqipërisë me BE, si dhe fondet e programet e Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë Shqiptare, institucionet vendore dhe qytetarët. Gjithkush në Shqipëri është i mirëpritur të vizitojë ose të pyesë për Këndin e tij të BE në qytetin e tij.

A TË DUKET INTEGRIMI NË BE I VËSHTIRË PËR T’U KUPTUAR?

MUND TË MËSOSH MË SHUMË PËR TË pranë KËNDIT TË BE NË QYTETIN TËND

Këndi i BE në qytetin tënd mund të të ndihmojë të gjesh informacion më të specializuar në lidhje me Bashkimin Evropian. Ky informacion mund të përmbledhë çdo gjë, që nga organizimi dhe zhvillimi i BE, deri në fusha politike të veçanta, të tilla si arsimi dhe trajnimi, shoqëria civile, mjedisi, politikat rajonale, zgjerimi dhe tregu i përbashkët, zhvillimi ekonomik dhe bujqësia.

KËNDI I BE NË QYTETIN TËND

ndihmon një gamë të gjerë njerëzish për të kuptuar aspektet e ndryshme të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE.

EJA NË KËNDIN E BE, PËR TË MËSUAR MË SHUMË

- Këndi Juaj i BE mund të ofrojë informacion në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian të vlefshme për bashkitë, grupet e shoqërisë civile, individët, komunitetin e biznesit, studentët, fermerët, shkollat dhe universitetet.
- Këndi Juaj i BE mund të shpjegojë strukturat themelore të Bashkimit Evropian për shkollat fillore dhe të mesme.
- Këndi Juaj i BE mund të ndihmojë studentët e universiteteve që të informohen mbi edukimin në BE, trainimet si dhe programe të tjera për të rinj.
- Këndi Juaj i BE mund të informojë gjithashtu median lokale, apo grupime të tjera mbi projektet dhe programet e mbështetura nga BE në Shqipëri.

NE U PERGJIGJEMI PYETJEVE TUAJA MBI BASHKIMIN EVROPIAN



GJITHKUSH ËSHTË I MIRËPRITUR TË NA VIZITJË DHE TË SHFRYTËZOJË BIBLIOTEKËN E KËNDIT TË BE NË QYTET

Për më tepër, ne organizojmë një sërë debatesh, seminaresh, kursesh dhe trajnimesh rreth integrimit në BE, për tema të veçanta si edhe veprimtari të ndryshme kulturore. Disa nga këto aktivitete organizohen nga Koordinator i BE në qytetin tuaj, dhe të tjerat në bashkëpunim me projektin “Bashkitë për në Evropë”, apo me partnerë të tjerë evropianë si për shembull, Ambasadat e Vendeve Anëtare të Bashkimit Evropian në Shqipëri.

KËNDI I BE NË QYTETIN TUAJ ka për qëllim të jetë në kontakt të vazhdueshëm me publikun si dhe të shpjegojë gjithçka që ai kërkon të dijë rreth BE.